




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI



Handwritten signature and date 20.11.18

Lënda:

Propozim amendament për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9975, dt.28.07.2008, “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave

DREJTUAR:

Z. Erjon BRAÇE

KRYETAR I KOMISIONIT PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Për dijeni:

Z. Gramoz RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT ✓

BAZA LIGJORE:

Rregullorja e Kuvendit, neni 71

I nderuar zoti Kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

Bazuar në nenin 71 të Rregullores së Kuvendit, propozoj që në projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9975, dt.28.07.2008, “Për Taksat Kombëtare”, të ndryshuar, të bëhet shtesa e mëposhtme:

Pas pikës 1 të nenin 2, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Në pikën 4, në paragrafin e parë, fjalia e parafundit ndryshon me këtë përmbajtje: “25% e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria”.”

ARSYETIMI I AMENDAMENTIT:

Parashikimi në ligj për herë të parë i shpërndarjes së rentës minerare për pushtetin vendor ku zhvillohet veprimtaria, u bë në vitin 2010, me anë të ligjit nr.10280, dt.20.05.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për Taksat Kombëtare", të ndryshuar, ku u parashikua që “25 për qind e të ardhurave nga renta minerare i kalojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria”.

Mirëpo, bashkitë dhe komunat në këtë periudhë, nuk mernin sipas këtij ligji, 25% të të ardhurave nga renta, pasi në ligjin e buxhetit të shtetit kufizohet marrja e kësaj rente, duke e lidhur atë me shumën e transfertës së pakushtëzuar.

Që do të thotë se, bashkitë ose komunat, do të përfitonin rentë minerare, vetëm nëse sipas informacioneve të drejtorive rajonale të tatimeve dhe doganave, renta e llogaritur për ato, do të kalonte vlerën e transfertës së pakushtëzuar për vitin përkatës, gjë e cila jo në të gjitha njësitet vendore ku zhvillohet veprimtaria, kishte mundësi objektive për tu realizuar.

Rrjedhimisht, qëllimi i përcaktuar në ligj, për t'iu shpërndarë të ardhura njësive vendore të pasura me minerale e hidrokarbure, nuk zbatohet.

Nga viti 2015 e në vijim, marrja e rentës minerare nga pushteti vendor, nuk do të lidhej më me shumën e transfertës së pakushtëzuar.

Kjo bëri që ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për Taksat Kombëtare", të ndryshuar, të ndryshonte me anë të ligjit 157/2014, ku u vendos se pjesa e të ardhurave nga taksa e rentës minerare që do t'i kalojë pushtetit vendor, do të ulet nga 25%, në 5%, me arsyetimin se, tashmë që marrja e rentës minerare nga pushteti vendor, nuk do të lidhej më me shumën e transfertës së pakushtëzuar, do t'i kalojnë më shumë të ardhura nga renta minerare.

Por nga një studim i kryer për Bashkinë Selenicë, mbi të ardhurat që ka përfituar nga renta minerare për 4 vitet e fundit, si një zonë e pasur me naftë e gaz por edhe me minerale të tjera si qymyri bituminoz, në të cilën ushtrohet veprimtaria e shfrytëzimit, rezulton se në total kjo vlerë për 4 vitet, 2015-2018, është vetëm 6 149 291 lekë.

Kjo shumë e ulët e rentës minerare që iu shpërndahet njësive vendore për kryerjen e investimeve, , vjen si pasojë e vlerës tepër të vogël prej 5% e përcaktuar në ligj, e cila i kalon pushtetit vendor nga të ardhurat e taksës së rentës minerare.

Duke qenë se për dekada me radhë, këto zona të pasura me pasuri nëntokësore, i kanë dhënë shtetit të ardhura nga shfrytëzimi i tyre, e nga ana tjetër prej vitesh nuk është investuar në rehabilitimin e rrugëve, ndërtimin e ujësjellësave etj, rritja pjesës së të ardhurave nga renta minerare që i kalojnë pushtetit vendor dhe përdorimi i tyre për investime sipas detyrimit të përcaktuar në ligj, do të ndikojë në përmirësimin e jetesës së banorëve që jetojnë në këto zona.

Prandaj, me anë të këtij amendamenti, propozohet rritja e të ardhurave nga renta minerare që i kalojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria, nga 5% në 25%, pasi njësitet e qeverisjes vendore të cilat janë të pasura me pasuri nëntokësore, në fakt, përfitojnë shumë pak nga këto pasuri.

Ky amendament, nuk vjen në kundërshtim me ndryshimet e propozuara në projektligj.

DEPUTETI

Vullnet SINAJ

